



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 773/5 Prot.

Tiranë, më 11.01. 2016

V E N D I M
Nr. 3, datë 11.01.2016

*“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,
filluar me Urdhrin nr. 773/1 prot., datë 12.11.2015”*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Bashkinë Fushë-Arrëz, për rastet e nëpunësve ***** , ***** dhe ***** ,

VËREJ SE :

Me Urdhrin nr. 773/1 prot., datë 12.11.2015, ka filluar procesi i verifikimit të informacionit të përcjellë nëpërmjet kërkesës protokolluar me nr. 773 prot., datë 06.11.2015, në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për shkak ristrukturimi, të punonjësit ***** , si “Inspektor Pyjesh” në Njësinë Administrative Qafë-Mali, Bashkia Fushë-Arrëz.

Gjatë këtij procesi, pranë institucionit të Komisionerit, janë paraqitur edhe disa informacione të tjera dhe konkretisht nga punonjësi ***** , njoftuar me kërkesën nr. 798 prot., datë 13.11.2015 dhe nga punonjësi ***** , njoftuar me kërkesën nr. 841 prot., datë 23.11.2015, nga përmbajtja e të cilëve, rezultoi se objekti i informacionit (që kishte lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për shkak ristrukturimi), institucioni dhe organi që ka nxjerrë aktin janë të njëjtë.

Në këto kushte, vendosa që këto informacione të trajtohen së bashku me Urdhrin nr. 773/1 prot., datë 12.11.2015, të nxjerrë për punonjës in ***** .

Nga aktet e administruara në dosje, ka rezultuar se:

*Nëpunësi ***** ka filluar marrëdhënien e punës në vitin 2008, fillimisht si inxhinier pyjesh, ndërsa aktualisht, ky pozicion ka emërtimin “Inspektor Pyjesh”, në Komunën Qafë-Mali (tashmë Njësia Administrative Qafë-Mali, në përbërje të Bashkisë Fushë-Arrëz).*

*Meqenëse fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur në këtë pozicion pune, me vjetërsi më shumë se një vit, me të drejtë njësia përgjegjëse e Komunës Qafë-Mali, me aktin nr. 138/1, datë 23.04.2015, ka deklaruar statusin e punësimit në shërbim civil, të punonjësit ***** , në pozicionin “Inspektor Pyjesh”.*

*Nëpunësi ***** , ka filluar marrëdhënien e punës që në vitin 2011, në pozicionin “Shef Finance”, pranë ish-Komunës Qafë-Mali (tashmë Njësia Administrative Qafë-Mali, nën varësinë e Bashkisë Fushë-Arrëz).*

Meqenëse fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur në këtë pozicion pune, me një vjetërsi më shumë se një vit, me të drejtë njësia përgjegjëse e ish-Komunës Qafë-Mali, me aktin nr. 130/1, datë 16.04.2015, ka deklaruar statusin e punësimit në shërbim civil, në pozicionin “Përgjegjës Finance”.

*Nëpunësi ***** , ka filluar marrëdhënien e punës pa shkëputje, në datën 16.01.2013, në pozicionin “Përgjegjës për Bujqësinë dhe Tatim Taksat”, pranë ish-Komunës Qafë-Mali (emërtesa e pozicionit të punës sipas strukturës së vjetër të Komunës Qafë-Mali dhe aktit të deklarimit të statusit të punësimit në shërbim civil, është “Përgjegjës për Bujqësinë dhe Tatim Taksat” ndërsa aktualisht, me strukturën e re, ka emërtimin “Inspektor Taksash”).*

Edhe në rastin e këtij punonjësi, meqenëse fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e gjeti në këtë pozicion pune, me një vjetërsi më shumë se një vit, me të drejtë njësia përgjegjëse e ish-Komunës Qafë-Mali, me aktin nr. 134/1, datë 20.04.2015, ka deklaruar statusin e punësimit në shërbim civil në pozicionin “Përgjegjës për Bujqësinë dhe Tatim Taksat”.

Shkaku i lindjes së mosmarrëveshjeve që janë objekt i këtij verifikimi, ka lidhje me ristrukturimin e Njesisë Administrative Qafë-Mali, që është diktuar nga hyrja në fuqi dhe veprimi i ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjin nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

Bazuar në dispozitat e akteve ligjore të përmendura me sipër dhe në ato të Kreut IV, të Vendimit nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Këshilli Bashkiak Fushë-Arrëz, me Vendimin nr. 10, datë 03.09.2015 “Për Miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, dhe të njësive administrative për vitin 2015 dhe niveli i pagave”, ka miratuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi dhe të njësive administrative të saj. Në zbatim të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë me Urdhrin nr. 39, datë

29.09.2015, ka miratuar strukturën e institucionit, ku përfshihet edhe struktura e Njesisë Administrative Qafë-Mali.

Sipas kësaj strukture, rezulton se Njësia Administrative Qafë-Mali, ka pësuar shkurtrim të numrit të përgjithshëm të vendeve të punës, nga 14 pozicione që kishte struktura e mëparshme, (prej të cilave 8 pozicione pune, pjesë e shërbimit civil), në 9 pozicione në strukturën e re (prej të cilave 5 pozicione pune, pjesë e shërbimit civil).

Në këto rrethana, duke u nisur, vetëm nga fakti i shkurtrimit të numrit të përgjithshëm të vendeve të punës, Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, në kundërshtim me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, i Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” dhe Udhëzimit nr. 3, datë 14.04.2014, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, të Departamentit të Administratës Publike, është mjaftuar me nxjerrjen e akteve përkatëse për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës: për punonjësin *****, me aktin nr. 39/51, datë 29.09.2015; për punonjësin *****, me aktin nr. 39/52, datë 29.09.2015 dhe për punonjësin *****, me aktin nr. 39/48, datë 29.09.2015.

Nga vlerësimi i praktikës dokumentare, për mënyrën si është proceduar në rastet konkrete, konstatohet se ekzistojnë vetëm aktet administrative respektive, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të ristrukturimit për secilin punonjës dhe rezultojnë se mungojnë aktet e mëposhtme: **a)** Urdhri për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit; **b)** Dokumentacioni që materializon mënyrën si ka funksionuar ky komision dhe propozimet e tij në lidhje me transferimet, rrimërimet dhe lirimet nga shërbimi civil të punonjësve të institucionit, të cilëve u është shkurtuar apo ristrukturuar pozicioni i punës; **c)** Aktet administrative që provojnë marrjen e pëlqimit me shkrim nga nëpunësit të cilët janë të detyruar të transferohen në një pozicion tjetër për shkak të shkurtrimit ose ristrukturimit të pozicionit të mëparshëm të punës; **ç)** Aktet administrative që evidentojnë vendimmarrjen përfundimtare të njësisë përgjegjëse, për miratimin apo refuzimin e propozimeve të Komisionit të Ristrukturimit.

Nisur nga sa u analizua më sipër, konstatohet se, aktet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së nëpunësve ***** (nr. 39/51, datë 29.09.2015), ***** (nr. 39/52, datë 29.09.2015) dhe ***** (nr. 39/48, datë 29.09.2015), të cilat janë nxjerrë prej Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, për shkak të ristrukturimit të institucionit, kanë dalë duke mos respektuar rregullat dhe procedurën e parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, i Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, i Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” dhe Udhëzimit nr. 3, datë 14.04.2014, i Departamentit të Administratës Publike “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”.

Kjo shkelje e rëndë e procedurës, në bazë të neneve 115/a, 116/c dhe 117/1, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, sjell pavlefshmëri absolute të akteve administrative nr. 39/48, datë 29.09.2015; nr. 39/51, datë 29.09.2015; nr. 39/52, datë 29.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, “Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, sipas organikës vjetër e miratuar me VKB nr. 06, datë 10.03.2015”. Për këtë arsye, këto akte administrative duhet të revokohen dhe procesi i ristrukturimit si për rastet e punonjësve *****, ***** e *****, ashtu dhe për gjithë rastet e tjera të ngjashme në institucion, të cilat kanë dalë me të njëjtin objekt për shkak të ristrukturimit të institucionit, të kryhet nga fillimi sipas kërkesave të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve përkatëse nënligjore.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14, 15 dhe 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenet 115, pika “a”, 116 pika “c” dhe 117, pika 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative në R. SH”; nenin 35 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, për revokimin e:
 - a. aktit administrativ nr. 39/51, datë 29.09.2015, “Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës sipas organikës vjetër e miratuar me VKB nr. 06, datë 10.03.2015”, për punonjësin *****;
 - b. aktit administrativ nr. 39/52, datë 29.09.2015, “Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës sipas organikës vjetër e miratuar me VKB nr. 06, datë 10.03.2015”, për punonjësin *****;
 - c. aktit administrativ nr. 39/48, datë 29.09.2015, “Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës sipas organikës vjetër e miratuar me VKB nr. 06, datë 10.03.2015”, për punonjësin *****.
2. Të kryhet procesi i ristrukturimit të institucionit, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 50, pika 3 e vijues, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke filluar me ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, i cili duhet të funksionojë dhe veprojë sipas përcaktimeve dhe afateve ligjore, të vendosura në Kreun II dhe III, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil” dhe Udhëzimit nr. 3, datë 14.04.2014, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, të Departamentit të Administratës Publike.
3. Njësia përgjegjëse të kujdeset që, në rastin e pamundësisë së sistemimit të punonjësve që u është shkurtuar ose ristrukturuar pozicioni i punës, të vendoset përfundimi i

marrëdhënies në shërbimin civil, duke u njohur atyre, përfitimet prej pikave 7 dhe 8 të nenit të mësipërm, që kanë të bëjnë me dhënien e një shpërblimi në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil dhe mundësinë që brenda një periudhe 2 vjeçare, të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, ose të emërohen në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil, që lirohen përkohësisht, për shkak sëmundje, leje lindje e arsye të tjera ligjore.

4. Në përfundim të këtij procesi, njësia përgjegjëse duhet të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me aktet përkatëse, ku të paraqitet situata pas ristrukturimit e të materializohen si nëpunësit civilë të sistemuar pas ristrukturimit ashtu dhe ata që do të lirohen për shkak të shkurtimit të vendeve të punës.
5. Bashkia Fushë-Arrëz, të zbatojë pikën 1, të këtij vendimi brenda 15 ditëve nga data e marrjes dijeni, dhe pas këtij afati të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për zbatimin e vendimit.
6. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Fushë-Arrëz dhe nëpunësit *****
***** e *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA